



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 15950 prot.

Shkodër, më 05.08. 2025

**VENDIM
Nr.53, datë 04.08.2025**

**“PËR PËRDITËSIMIN E VKK RRETHINA NR. 43, DATË 20.12.2010, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË
KOMUNËN RRETHINA, INVENTARIZIMIN DHE MIRATIMIN E KËRKESËS PËR
TRANSFERIMIN E TYRE NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 04.08.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, dhe nenit 9, pika 1.2, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, neni 3; të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV; të VKM nr. 28, datë 27.01.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”; të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e tyre në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; të VKK Rrethina nr. 43, datë 20.12.2010, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Rrethina”; të udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”; të shkresës nr. 3368/2, datë 09.06.2025, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; si dhe mbi bazën e dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë përditësimin e VKK Rrethina nr. 43, datë 20.12.2010, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Rrethina, inventarizimin dhe miratimin e kërkesës për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër”, për pasuritë me të dhëna sipas tabelës bashkëlidhur.

Nr. Inv	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronë/pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë	Inventari	Te dhëna të tjera
						Trup	Ndërtesë				me	(Shënime të veçanta)
						(m2)	(m2)				VKM	
862	1790 K-34-64(177-B)	61/7		Qendra Shëndetësore Golem	120	120	68	Shëndetësi	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
863	1790 K-34-64(177-B)	61/7		Shkolla 9-vjeçare "Haxhi Hajdari" Golem	2100	2100	713+77-5	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
864	3949 K-34-63(240-A)	52		Qendra Shëndetësore Zues	115	115	40	Shëndetësi	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
865	3949 K-34-63(240-A)	63, 64		Shkolla 9-vjeçare Zues	1050	1050	400	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		Prona pozicionohet mbi pas nr. 63 dhe 64
866	1105, K34-64(178-D)	7/1		Qendra Shëndetësore Bardhaj	55	55	35	Shëndetësi	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
867	Z1105, K34-64(178-D)	7/1		Shkolla 9-vjeçare Bardhaj	2700	2700	720	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
868	Z1105, K34-64(178-D)	336		Shkolla 9-vjeçare Bardhaj Aneks/Kopsht	650	650	200	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
869	1965, K-34-64(162-D)(178-B)	228/9		Shkolla 9-vjeçare "Ded Gjon Luli" Hot i Ri	1900	1900	437	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
870	1495, K-34-64(177-D)(193-B)	268/6		Shkolla 9-vjeçare "Isa Jakupi" Dobraç	1900	1900	512	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
871	1495, K-34-64(177-D)	264/1		Qendra Shëndetësore Dobraç	425	425	212	Shëndetësi	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
872	1495, K-34-64(177-D)	264/1		Kopshti Dobraç	360	360	195	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
873	3429 K-34-64(161-A)	22/11		Shkolla 9-vjeçare "Fiko Cani" Shtoj i Vjeter	3900	3900	500	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
874	3429 K-34-64(161-A)	22-1		Qendra Shëndetësore Shtoj i Vjeter	320	320	320	Shëndetësi	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
875	1869 K-34-64(162-C)	126/23		Shkolla 9-vjeçare "Tringë Smajli" Grudë e Re	4280	4280	562	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		

Adresa: Rr. "13 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiaShkodër.gov.al, e-mail: info@bashkiaShkodër.gov.al

876	1869	379/6	Qendra Shëndetësore Grudë e Re	320		152	Shëndetësi	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
877	3428	135/1	Shkolla 9-vjeçare "Osman Dhampiraj" Shtoj i Ri	1165	1165	317	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
878	3428	136	Qendra Shëndetësore Shtoj i Ri	156	156	83	Shëndetësi	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
879	3428	136	Kopshti Shtoj i Ri	692	692	254	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
880	1880	32/8	Shkolla 9-vjeçare "Ismet S.Brucaj" Guci e Re	2681	2681	626	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		
881	1880	32/8	Qendra Shëndetësore Guci e Re	128	128	39	Shëndetësi	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër		

2. Fusha e përdorimit të këtyre pasurive do të jetë për realizimin e funksioneve arsimore dhe shëndetësore.
3. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër, duke bashkërenduar punën me institucionet përgjegjëse.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Miratuar me 33 vota

Vota Pro 33
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 05.08.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj




Adresa: Rr. "13 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiaShkodër.gov.al, e-mail: info@bashkiaShkodër.gov.al